



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 104/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTG “Blendi” me numër të biznesit, dhe seli në Prishtinë, rr., nr. ..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.D, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 537/17, i lejuar me datë 27.12.2017, nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.537/17, i lejuar me datë 27.12.2017, nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NTG “Blendi”, mbi bazën e faturave nr. 17-210-001-2409, nr. 17-210-001-2410, nr. 17-210-001-2411, nr. 17-210-001-2412, nr. 17-210-001-2413, nr. 17-210-001-2414, nr. 17-210-001-2415, nr. 17-210-001-2416, nr. 17-210-001-2417, nr. 17-210-001-2418, nr. 17-210-001-2419, nr. 17-210-001-2420, nr. 17-210-001-2421, nr. 17-210-001-2422, nr. 17-210-001-2423, nr. 17-210-001-2424, nr. 17-210-001-2425, nr. 17-210-001-2426, nr. 17-210-001-2427, nr. 17-210-001-2428, nr. 17-210-001-2429, nr. 17-210-001-2430, nr. 17-210-001-2431, nr. 17-210-001-2432, nr. 17-210-001-2433, nr. 17-210-001-2434, nr. 17-210-001-2435, nr. 17-210-001-2436, nr. 17-210-001-2437, nr. 17-210-001-2438, nr. 17-210-001-2439, nr. 17-210-001-2440, nr. 17-210-001-2441 të datës 11.09.2017 dhe faturave nr. 17-210-001-2442, nr. 17-210-001-2443, nr. 17-210-001-2444, nr. 17-210-001-2445, nr. 17-210-001-2446, nr. 17-210-001-2447, nr. 17-210-001-2448, nr. 17-210-001-2449, nr. 17-210-001-2450, nr. 17-210-001-2451, nr. 17-210-001-2452, nr. 17-210-001-2453, nr. 17-210-001-2454, nr. 17-210-001-2455, nr. 17-210-001-2456, nr. 17-210-001-

2457, nr. 17-210-001-2458, nr. 17-210-001-2459, nr. 17-210-001-2460, nr. 17-210-001-2461, nr. 17-210-001-2462, nr. 17-210-001-2463, nr. 17-210-001-2464, nr. 17-210-001-2465, nr. 17-210-001-2466, nr. 17-210-001-2467, nr. 17-210-001-2468, nr. 17-210-001-2469, nr. 17-210-001-2470 te datës 12.09.2017, ka lejuar urdhrin për përmbarim P.nr.537/17, të datës 27.12.2017, me të cilin është urdhëruar debitori Komuna e Prishtinës që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit borxhin prej EUR 13,781.00, me kamatë prej 8% nga dita kur ka qenë i obliguar ta paguaj borxhin e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbarimore si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, në lartësi prej EUR 208.00.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se përmbaruesi privat nuk ia ka bashkangjitur urdhrin dëshminë se debitori ka bërë pranimin e faturës sipas procedurës së pranim dorëzimit të konfirmuar me anë të nënshkrimit. Tutje ka theksuar se faturat nuk janë dorëzuar në origjinal dhe se nuk është prezantuar kontrata ndërmjet kreditori si operator ekonomik dhe debitorit si autoritet kontraktues. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, dhe të anulohet apo shtyhet ekzekutimi i urdhrin përmbarimor

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësim përmes së cilës ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe pretendimet e debitorit nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin. Tutje, ka shtuar se përmes dëftesave vërtetohet nënshkrimi dhe pranimi i mallrave nga ana e debitorit, ndërsa ka theksuar se me ligj nuk kërkohet nënshkrimi i faturave nga ana e debitorit. Gjykatës, i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe urdhri për caktimin e përmbarimit të mbetet në fuqi. Poashtu, i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në lartësi prej EUR 208.00.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejshëm referuar si: 'LPP'), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton

se fatura është dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në anën tjetër paragrafi 3, i nenit 29 të LPP-së, përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Në mbështetje të dispozitave si më lartë, gjykata gjeti se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se, në rastin konkret, nuk mund të vërtetohet që të njëjtat fatura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat i janë dorëzuar debitorit, pasi që të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe pranuar nga debitori, dhe rrjedhimisht, si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbartim.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e kreditori të paraqitura në përgjigje në prapësim në raport me dëshmitë mbi pranim të rregullt të mallrave, sipas dëftesave për dorëzimin e mallrave të cilat ia ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim, mirëpo dëftesat mbi dorëzimin e mallrave nuk paraqesin dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, andaj të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i kësaj procedure.

Gjykata rikujton se kjo procedure i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së. Gjithsesi, kjo vendosje nuk e paragjykon të drejtën e palës kreditore që për realizimin e kërkesave eventuale në raport me debitorit, të zhvilloj kontest të rregullt civil, pranë gjykatës kompetente.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.104/22, datë 29.05.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.